

# GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

## SEKSIONI I TRETË

### VENDIM

*Kërkesa nr. 11674/17*

## SOKOL GAZULLI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 12 shtator 2023 si një Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 11674/17) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 4 shkurt 2017 nga një shtetas shqiptar dhe kanadez, z. Sokol Gazulli, lindur në vitin 1970 dhe banues në Lezhë ("kërkuesi"), i cili u përfaqësua nga znj. F. Gazulli me banim në Lezhë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë Shqiptare ("Qeveria"), e cila u përfaqësua nga agjentja e saj në atë periudhë, znj. B. Lilo, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi, vendosi si më poshtë:

### LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkuesi u gjobit nga autoriteti doganor dhe iu kërkua të parapaguante një pjesë të gjobës përpara se ta kundërshtonte atë. Kërkuesi u ankua se kërkesa shkelte të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

#### **A. Procesi administrativ në lidhje me përjashtimin nga një detyrim doganor**

2. Pasi kishte jetuar jashtë vendit për një sërë vitesh, kërkuesi u kthye në Shqipëri në muajin mars 2010. Ai pretendoi se në këtë periudhë ai kishte importuar në Shqipëri makinën e tij personale, por nuk kishte kaluar në procedurat e zakonshme të importit në kufi, pasi oficerët e kufirit nuk kishin mundur ta informonin për procedurën e saktë që duhej të ndiqej.

3. Në muajin prill 2011, ai përdori makinën e tij për të udhëtuar jashtë vendit dhe më pas, për të rihyrë në Shqipëri.

4. Në muajin mars 2012, kërkuesi kërkoi nga autoriteti përkatës tatimor të përjashtojë nga detyrimet doganore për makinën me arsyetimin se sipas ligjit vendas, emigrantët që kthehen në Shqipëri përjashtohen nga detyrimet doganore për makinat e tyre personale. Ministria e Financave e rrëzoi kërkesën në muajin prill 2012, me arsyetimin se sipas të dhënave të tyre, makina kishte hyrë në Shqipëri në muajin prill 2011 (shih paragrafin 3 më sipër), që do të thotë më shumë se një vit më vonë pas kthimit të kërkuesit në Shqipëri, që kishte ndodhur në muajin mars 2010 (shih paragrafin 2 më sipër).

5. Në periudhën midis vitit 2012 dhe 2015, kërkuesi shprehu mospajtimin e tij me këtë vendim me anë të korrespondencës elektronike me autoritetet vendase.

#### **B. Procesi në lidhje me gjobën e doganës**

##### *1. Procesi administrativ*

6. Më 30 qershor 2015, kërkuesi iu nënshtrua një inspektimi rastësor nga oficerët doganorë. Ata sekuestruan makinën e tij, përpiluan të dhënat përkatëse dhe e referuan çështjen pranë Zyrës Doganore Shkodër për një vendim.

7. Më 3 korrik 2015, Zyra Doganore Shkodër konstatoi se kërkuesi nuk kishte paguar detyrimin doganor për makinën e tij. Gjithashtu, ajo konstatoi se kërkuesi kishte pasur dijeni se kërkesa për përjashtim nuk ishte pranuar dhe se ai nuk kishte filluar ndonjë proces gjyqësor për ta kundërshtuar atë vendim. Në vijim, Zyra Doganore Shkodër, me anë të një vendimi të së njëjtës datë, e urdhëronte të paguante 347,611.5 lekë (ALL) për detyrimin doganor të pashlyer dhe një gjobë të barabartë me 100% të detyrimit (që do të thotë një shumë në total prej 695,223 ALL – afërsisht rreth 5,604 euro (EUR)).

8. Më 9 korrik 2015, kërkuesi e kundërshtoi vendimin e mësipërm pranë organit administrativ të shkallës së dytë, më konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (“DPD”). Më 3 gusht 2015, DPD-ja e informoi kërkuesin se kundërshtimi i tij ishte i papranueshëm, pasi përpara se të kundërshtonte vendimin e organit të shkallës së parë, kërkuesi nuk kishte shlyer detyrimin doganor të kontestuar dhe 40% të gjobës sipas parashikimit të nenit 289 § 3 të Kodit Doganor (ligji nr. 8449, i datës 27 janar 1999, i ndryshuar).

## 2. Procesi gjyqësor

9. Kërkuesi i kundërshtoi të dy vendimet administrative pranë Gjykatës Administrative Shkodër, e cila, më 14 tetor 2015, e deklaroi padinë e tij të papranueshme me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet administrative pasi DPD-ja nuk kishte shqyrtuar meritat e ankesave për shkak të mosrespektimit të parashikimeve për pranueshmërinë pranë atij organi.

10. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesi depozitoi një apelim të posaçëm pranë Gjykatës së Lartë. Ai argumentoi se si emigrant që po kthehej në vendin e tij, ai duhej të ishte përjashtuar nga detyrimi doganor. Më 17 dhjetor 2015, Gjykata e Lartë la në fuqi arsyetimin dhe përfundimin e gjykatës më të ulët pa shqyrtuar meritat e gjobës.

11. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesi u ankua pranë Gjykatës Kushtetuese. Një prej argumenteve të tij ishte se rregulli, sipas nenit 289 § 3 të Kodit Doganor, sipas së cilit ai duhej të paguante detyrimin doganor të kundërshtuar dhe 40% të gjobës përpara se të kundërshtonte vendimet përkatëse administrative shkaktonte një ndërhyrje joproporcionale me të drejtën e individëve për t’iu drejtuar gjykatës, sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Sipas këndvështrimit të kërkuesit ajo kërkesë ishte e pafavorshme për kërkuesit dhe në këtë mënyrë, mund të dekurajonte apelimet në atë fushë, si edhe ishte jo proporcionale.

12. Më 11 nëntor 2016, Gjykata Kushtetuese vendosi se apelimi kushtetues i kërkuesit synonte të kundërshtonte *in abstracto* kushtetueshmërinë e Kodit Doganor, dhe kërkuesi nuk kishte pozita juridike në këtë proces. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese e deklaroi apelin të papranueshëm.

13. Kërkesa ka të bëjë me ankesën e kërkuesit për pretendimin për shkelje të së drejtës së tij për t’iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës, sipas kërkesës për të parapaguar një pjesë të gjobës së doganës përpara se të mund ta kundërshtonte atë. Gjithashtu, kërkesa ka të bëjë edhe me pretendimin për shkelje të nenit 1 të Protokollit, nr. 1 të Konventës.

## VLERËSIMI I GJYKATËS

### A. Neni 6 § 1 i Konventës

14. Çështjet në lidhje me taksat, si këto që tashmë gjenden pranë Gjykatës, krijojnë esencën e prerogativës së autoritetit publik ku natyra publike e marrëdhënies midis taksapaguesit dhe komunitetit mbetet predominuese, pavarësisht efekteve pasurore që mosmarrëveshjet tatimore shkaktajnë detyrimisht për taksapaguesin. Për rrjedhojë, neni 6 § 1 i Konventës nuk është i zbatueshëm për sa i përket aspektit të tij civil (shih, më së fundmi, *Vegotex International S.A. kundër Belgjikës* [DHM], nr. 49812/09, § 66, 3 nëntor 2022).

15. Megjithatë, është konstatuar se aspekti penal i nenit 6 § 1 zbatohet për tarifat tatimore shtesë, të cilat nuk konsiderohen si kompensim monetar për dëmin, por si dënim për të parandaluar përsëritjen e shkeljes (*Jussila kundër Finlandës* [DHM], nr. 73053/01, § 38, GJEDNJ 2006-XIV).

16. Në çështjen konkrete, përveç detyrimit doganor, autoritetet vendosën ndaj kërkuesit edhe një dënim shtesë të barasvlershëm me 100% të detyrimit (shih paragrafin 7 më sipër), i cili *prima facie* duket të ketë pasur një natyrë ndëshkuese. Në çdo rast, nuk është e nevojshme të shqyrtohet

në detaj kuadri dhe natyra ligjore e atij dënimi pasi ankesa është e papranueshme për arsyet e paraqitura në vijim.

17. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk është absolute. Ajo mund t'i nënshtrohet kufizimeve të lejuara me anë të interpretimit, veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një apelimi. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë ushtrimin e së drejtës në një mënyrë të tillë ose në një masë të tillë që të cenohet vet thelbi i së drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe duhet të kenë një proporcionalitet të drejtë midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih *Omar kundër Francës* ([DHM] nr. 24767/94, § 34, 29 korrik 1998).

18. Në çështjen konkrete, kufizimi ndaj së drejtës së kërkuarit për t'iu drejtuar gjykatës vinte nga kërkesa për të parapaguar shumën kryesore të detyrimit doganor dhe 40% të gjobës përpara se të bëhej ankesa për rivlerësim të borxhit. Kërkuari nuk argumentonte – dhe Gjykata nuk ka arsye të gjykojë – se kërkesa nuk ndiqte një qëllim legjitim (krahaso me arsyetimin në *Leduc kundër Francës*, (vendim) [Komiteti], nr. 16382/16, § 28, 17 tetor 2017, dhe vendimet e cituara në të).

19. Për sa ka të bëjë me proporcionalitetin, në parashtrimet e tij përpara gjykatave normale vendase, kërkuari këmbëngulte se duke qenë se detyrimi fillestar doganor ishte i paligjshëm, atij nuk duhej t'i kërkohej të paguante ndonjë shumë përpara se ta kundërshtonte atë. Kërkuari nuk argumentoi përpara këtyre gjykatave se shumta e cila kërkohej të parapaguhej ishte e tepërt ose se ajo vendoste një barrierë të paarsyeshme ose ndaluese për të ushtruar të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatës (shih paragrafin 11 më sipër). Në këtë mënyrë, kërkuari u ankua kryesisht për vet detyrimin për të paguar sipas ligjit vendas, dhe jo për proporcionalitetin e tij në çështjen e kërkuarit. Gjithashtu, ai nuk iu dha autoriteteve vendase ndonjë element faktik për situatën e tij financiare në mënyrë që ato autoritete të mund të vlerësonin proporcionalitetin e kërkesës për të parapaguar shumën në fjalë përkundrejt gjendjes së tij financiare (shih, për një situatë të ngjashme, *Tcaciuc dhe të Tjerët kundër Rumanisë* (vendim) [Komiteti], nr. 43695/05 dhe 5 të tjerë, § 28, 4 shtator 2008, me referenca të tjera; dhe krahaso me *Loncke kundër Belgjikës*, nr. 20656/03, § 51, 25 shtator 2007, ku kërkuari ngriti një argument mbi të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës). Edhe pse ai iu referua së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës pranë Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 11 më sipër), siç konstatohet nga Gjykata Kushtetuese, këto argumente ishin paraqitur *in abstracto* (shih paragrafin 12 më sipër). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata përsërit se detyra e saj nuk është të rishikojë ligjin përkatës dhe praktikën *in abstracto*, por të përcaktojë nëse mënyra me anë të së cilës ato u zbatuan, apo ndikuan ndaj kërkuarit, shkaktoi një shkelje të Konventës ose jo (shih, midis autoriteteve të tjera, *Schwarzenberger kundër Gjermanisë*, nr. 75737/01, § 37, 10 gusht 2006; *Roman Zakharov kundër Rusisë* [DHM], nr. 47143/06, § 164, GJEDNJ 2015).

20. Në mungesë të argumenteve të paraqitura në mënyrën e duhur në procedurat vendase, Gjykata nuk mund të konstatojë se kufizimi i së drejtës së kërkuarit për t'iu drejtuar gjykatës ka qenë jo proporcional.

21. Së fundmi, në lidhje me argumentin e kërkuarit se autoritetet vendase gabuan me ligjin duke gjykuar se ai duhej të parapaguante shumën përkatëse përpara se të depozitonte ankesën ndaj gjobës, Gjykata nuk konstaton ndonjë arsye për të gjykuar se konstatimi ishte arbitrar ose qartazi i paarsyeshëm (shih *Moreira Ferreira kundër Portugalisë (nr.2)* [DHM], nr. 19867/12, §§ 83 dhe 85, 11 korrik 2017).

22. Për sa më sipër, Gjykata vendos se çështja nuk paraqet ndonjë fakt të shkeljes të së drejtës së kërkuarit për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

#### **B. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës**

23. Në rastin kur një kërkuar nuk respekton kërkesat vendase të pranueshmërisë, kërkesa e tij ose e saj pranë Gjykatës, në parim, duhet të deklarohet e papranueshme për mosshkrim të mjeteve vendase (shih *Vučković dhe të Tjerët kundër Serbisë* (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, § 72, 25 mars 2014).

24. Në çështjen konkrete, pretendimi vendas i kërkuarit u shpall i papranueshëm, pasi ai nuk kishte shteruar mjetet administrative përpara se t'i drejtohej gjykatës (shih paragrafin 22 më sipër). Rrjedhimisht, ankesa e bërë në mbështetje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës pranë

Gjykatës është e papranueshme për mosshërim të mjeteve vendase sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, në mënyrë unanime, Gjykata

*E deklaron* kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 5 tetor 2023.

**Olga Chernishova**  
ZËVENDËSSEKRETARE

**Georgios A. Serghides**  
KRYETAR